

RREGULLORE NR. 2005/39

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 1999/3
MBI THEMELIMIN E DOGANËS DHE SHËRBIMEVE TË TJERA
PËRKATËSE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi Autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në harmoni me nenet 8.1 (c) dhe (f) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001) dhe pas konsultimit me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal,

Pas shpalljes së Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/3 të datës 21 gusht 1999 mbi themelimin e doganës dhe të shërbimeve të tjera përkatëse në Kosovë,

Duke ditur se parimet e Marrëveshjes së Firencës të sponsorizuar nga UNESCO-ja për importimin e materialeve arsimore, shkencore dhe kulturore kërkojnë nga palët nënshkruese që të mos i ngarkojnë me obligimet doganore librat, broshurat, fletushkat, gazetatat, revistat dhe botimet periodike të shtypura,

Duke marrë parasysh se Pjesa B e shtojcës I të Rregullores së ndryshuar UNMIK-ut nr. 1999/3 e paraqet listën e të gjitha mallrave me tarifë zero të taksës doganore dhe

Me qëllim të ndryshimit të Pjesës B të shtojcës I të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/3 për të lejuar tarifën zero për librat, broshurat, fletushkat, gazetatat, revistat dhe botimet periodike të shtypura,

Me anë të kësaj shpall:

Neni 1
Ndryshimi

Pjesa B e shtojcës I të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/3 zëvendësohet me shtojcën e kësaj Rregulloreje.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 3 gusht 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Pjesa B**Lista e mallrave me tarifë zero të taksës doganore**

Kodi tarifor	Përshkrimi
0105 11 deri 0105 19	Shpezë të gjalla, d.m.th. pula të llojit Gallus domesticus, rosa, pata, gjela deti, dhe pula afrikane, të cilët nuk peshojnë më shumë se 185 g
0601 dhe 0602	Drunj dhe bimë të tjera të gjalla; qepujka, rrënjë dhe të ngjashme, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
0701 1000 0703 1011	Patate, farë Qepë, fidane
1001 1000 1001 9010 1001 9091 ex 1002 0000 1003 0010 ex 1004 0000 1005 10	Grurë i fortë Speltë për mbjellje Grurë i zakonshëm dhe përzierje thekre e gruri, farë Thekër, farë Elb, farë Tërshërë, farë Misër, farë
1201 0010 1206 0010 1209	Kokrra soje për mbjellje Farëra luledielli, për mbjellje Farëra, kokrra dhe spore, lloj që përdoret për mbjellje
1507 1090 1512 1191 ex 1514 1190 1515 2190	Vaj soje i papërpunuar për prodhimin e artikujve ushqimorë, që konsumohen nga njerëzit Vaj luledielli i papërpunuar për prodhimin e artikujve ushqimorë, që konsumohen nga njerëzit Vaj rrepe i papërpunuar për prodhimin e artikujve ushqimorë për konsumim të njerëzve Vaj misri i papërpunuar për prodhimin e artikujve ushqimorë për konsumim të njerëzve

2301 deri 2308	Mbetjet dhe mbeturinat nga industria ushqimore, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
2309 90	Produkte të ndryshme që përdoren për ushqimin e kafshëve (me përjashtim të ushqimit për qen dhe maca, të paraparë për shitje me pakicë)
2714	Bitumen dhe asfalt natyral; bituminuz ose vaj rreshpor dhe rërë e njomë me katran; asfalt dhe gurë asfalti
2716 0000	Energji elektrike
2806 1000	Klorid i hidrogjenit (acid hidroklorid)
2814 2000	Amoniak i tretur në ujë
Kapitulli 31	Plehra minerale, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
3201 deri 3207, 3211 dhe 3213	Ekstrakte për regjije dhe ngjyrosje; regjës dhe derivatet e tyre; ngjyra, pigmente dhe materje të tjera për ngjyrosje, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
3402 11 deri 3402 19	Mjete organike sipërfaqësisht aktive
3808	Insekticide, helme për brejtës, fungicide, herbicide, prodhime kundër mbrirjes dhe rregullator të rritjes së bimëve, prodhime dezinfektuese dhe prodhime të tjera për përdorim të ngjashëm në formë paketimi për shitje me shumicë ose si preparate apo artikuj
3901 deri 3914	Plastikë në formë primare, ashtu siç është përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
3915	Mbeturina, lëvore dhe copa të plastikës
4001 deri 4003	Goma në formë primare ose të pllakës, të fletës ose të shiritit, ashtu siç është përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
4005	Gomë e përzier, e pavullkanizuar, në formë primare ose të plakës, fletës ose shiritit, ashtu siç është përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
Kapitulli 41	Lëkurë e papërpunuar (me përjashtim të gëzofit) dhe lëkurë e përpunuar, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
4401	Dru për djegie, në trungje, tra, thupra, tufë thuprash ose në forma të tjera; dru në ashkla ose copëza; tallash, hedhurina dhe mbeturina druri i aglomeruar ose i paaglomeruar në tra, brikete, brikete cilindrike ose forma të ngjashme
4403	Dru i përpunuar, i pastruar ose jo nga korja a nga shtresa e nënkores ose i gdhendur vrazhdë në katër faqe

4801 0000	Letër shtypi në rule ose në fletë
4802	Letër e paveshur dhe karton, në rule ose fletë, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake; letër e bërë me dorë dhe karton;
4804 dhe 4805	Letër kraft e paveshur dhe lloje të tjera të letrës e të kartonit, në rule ose në fletë, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
4811	Letër, karton, veshje celuloze dhe fletë nga fije celuloze të veshura, të impregnuara, të mbuluara, sipërfaqsisht të ngjyrosura, sipërfaqsisht të dekoruara ose të shtypura në rule të fletëve katërkëndshe (duke përfshirë edhe ato katrore) të çfardo madhësie, përveç artikujve të llojeve të përshkruar në titujt 4803, 4809 dhe 4810
4812 0000	Shirita, plaka, fleta filtri prej pulpe të letrës
4901	Librat, broshurat, fletushkat e shtypura dhe botimet tjera të ngjashme qofshin në fletë të vetme ose jo
4902	Gazetat, revistat dhe botimet periodike, me ilustrime ose pa to apo që përmbajnë material reklamues
4907	Pulla të pashfrytëzuara postare, taksa dhe pulla të tjera të botimit aktual ose të ri në vendin ku ato kanë ose do të kenë vlerë të pranuar nominale; letër e stampuar; bankënota në formë çeqesh; aksione, obligacione ose letra me vlerë dhe letra të tjera të pronësisë
5101	Lesh, i pakrehur ose pashprishur
5110 0000	Fije nga qimet e papërpunuara të kafshëve ose nga grivet e kalit (duke përfshirë edhe fijet në kordon të griveve të kalit) pa marrë parasysh se a është vënë apo jo në shitje me pakicë
5201 deri 5207	Pambuk, përveç pëlhurave të endura, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
5401 deri 5406	Fije të bëra me dorë, përveç pëlhurave të endure, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
5501 deri 5511	Fije si lëndë e parë të bëra me dorë, përveç pëlhurave të endure, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën paraprake
6305	Thasët dhe qeset për nevoja të paketimit të artikujve nga materialet e tekstit